



Më
Dana 12 - 06 - 2018 NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ-Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni

Penal, si gjykatë e shkallës së parë penale, me gjyqtarin individual Elmaz Zenuni dhe me zyrtari ligjor Gazmend Bytyqi, në lëndën penale kundër të akuzuarit [REDACTED] nga fshati [REDACTED] Komuna e Ferizajt, për shkak të veprës penale blerja, pranimi ose fshehja e sendeve të përfituara me kryerjen e veprës penale nga neni 345 par.2 të KPRK-së, sipas akuzës së Prokurorisë Themelore në Ferizaj PP/II Nr.1094-2/15 të datës 07.06.2017 në shqyrtimin fillestar të hapur gjyqësor të mbajtur me datën 25.04.2018, në praninë e Prokurorit të shtetit Valdet Avdiu, të akuzuarit, të njejtën ditë mori dhe publikisht shpalli këtë:

A K T G J Y K I M

I akuzuari, [REDACTED] nga fshati [REDACTED] Komuna e Ferizajt, i lindur më [REDACTED], në fshatin [REDACTED] të Ferizajt, nga i ati [REDACTED] dhe ëma [REDACTED] e gjinisë [REDACTED], i punësuar në profesionin si murator në Ferizaj, i pa martuar, ka të kryer shkollën e mesme, i gjendjes së varfër ekonomike, shqitpar, shtetas i Kosovës, i pa gjykuar,

ËSHTË FAJTOR

Sepse më datën 24.05.2015 te tregu i veturave në Ferizaj i pandehuri ka blerë mallëra të vjedhura i vjedhur nga një person i pa njohur dhe ate telefon të markës "iphone 5", pronë e të dëmtuarës [REDACTED], edhe pse ka mund ta dijë se janë përfituar me anë të veprës penale vjedhja, për shkak të çmimit të ulët dhe mënyrës së shitjes,-

me të cilën ka kryer veprën penale blerja, pranimi ose fshehja e sendeve të përfituara me kryerjen e veprës penale nga neni 345 par.2 të KPRK-së .

Gjykata, në kuptim të nenit 345 par.2 të KPRK-së, dhe nenit 4,7,17, 23, 41, 46 dhe 73 KPRK-së, si dhe nenit 365 të KPPRK-së, e

GJYKON

Me dënim në të holla në shumë prej 100 /njëqind/ Euro, të cilat është i obliguar që ti paguaj në afatin prej 15 ditësh, pasi që aktgjykimi të merr formën e prerë.

Nëse dënimi me gjobë nuk mund të ekzekutohet as në mënyrat tjera të parapara nga nenin 46 par.3 të KPRK-së, gjykata do ta ekzekutoj aktgjykimin në atë mënyrë që të pandehurit për çdo 20 € të gjobës të vuaj në një ditë burgu.

Obligohet i akuzuari që në emër të shpenzimeve të paushallit gjyqsor të paguaj kësaj gjykate shumë prej 20 /njëzetë/ Euro, në afatin prej 15 ditësh pasi që aktgjykimi të merr formën e prerë nën kërcënimin e ekzekutimit me dhunë.

Konform nenit 39 par.3.1 të Ligjit për Kompensimin e Viktimave të Krimit –Ligji nr.05/L-036, Obligohet i akuzuari që në emër të Taksës për Kompensimin e Viktimave të Krimit të paguaj shumë prej 30 eurove, në afat prej 15 ditëve, nën kërcënimin e përmbarimit të dhunshëm.

E dëmtuara [REDAKTUAR] nga Ferizaji, Rruga [REDAKTUAR] pa nr., për realizimin kërkesë pasuroro-juridike udhëzohet në kontest civil.

Arsyetimi

Prokuroria Themelore në Ferizaj ka ushtruar aktakuzën e vetë PP/II Nr.1094/15 të datës 07.06.2017, kundër të akuzuarit [REDAKTUAR] nga fshati [REDAKTUAR] Komuna e Ferizajt, për shkak të veprës penale blerja, pranimi ose fshehja e sendeve të përfituara me kryerjen e veprës penale nga neni 345 par.2 të KPRK-së.

Gjykata duke vepruar në këtë çështje penale mbajti shqyrtimin fillestar gjyqësor me dt. 25.04.2018 në të cilën përfaqësuesi i akuzës - prokurori i shtetit Valdet Avdiu, lexoj aktin akuzues, dhe gjyqtari pasi që u bind se i pandehuri e ka kuptuar akuzën, konform nenit 246 të KPPRK-së, të pandehurit i ofroj mundësinë të pranoj fajësinë ose të deklarohet i pafajshëm.

I akuzuari [REDAKTUAR] nga Ferizaji pas këshillimeve dhe udhëzimeve të gjyqtarit në shqyrtimin fillestar gjyqësor konform nenit 246 KPPRK-së e ka pranuar veprën penale e cila i vëhet në barrë nga ana e prokurorisë.

E dëmtuara [REDAKTUAR] nga Ferizaj nuk ka prezentuar shqyrtimin fillestar gjyqësor pasi që konform nenit 245 par.7 të KPPRK-së nuk kërkohet prezenca e dëshmitarit-të dëmtuarit në këtë fazë të procedurës penale.

Gjykata konstatoi se janë plotësuar kriteret nga neni 248 të KPPRK-së, meqë i akuzuari ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimi të fajësisë, një pranimi i tillë është bërë vullnetarisht dhe atë pas udhëzimeve të gjyqtarit në kuptim të nenit 383 par.2 të KPPK-së dhe mbështet në faktet dhe provat e kësaj çështje penale siç janë: Vërtetimi mbi Konfiskimin e sendeve të sekuestruara përkohësisht i datës 17.06.2015, Vërtetimi për kthimin e sendeve të sekuestruara të dt.17.06.2015, dhe shkresat tjera të cilat gjinden në shkresat e lëndës.

Vlerësuar nga aspekti juridik gjykata gjeti se në veprimet e të akuzuarit manifestohen të gjitha elementet e veprës penale blerja, pranimi ose fshehja e sendeve të përfituara me kryerjen e veprës penale nga neni 345 par.2 të KPRK-së .

(Nëse i pandehuri në shqyrtimin fillestar pranon fajësinë dhe Kryetari i trupit gjyqësor dërgon se pranimi i fajit është bërë në pajtim me ligjin mund të vazhdoj procesin me shqyrtimin e dënimit duke mos administruar fare prova, pa plotësuar trupin gjyqësor dhe pa e mbajtur fare shqyrtimin gjyqësor, si dhe pa paraqitur fare fjalë përfundimtare, lidhur me këtë shih Mendimin Juridik të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës të evidentuar si GJA.nr.207/13 të dt.19.03.2013).

Me rastin e caktimit të llojit dhe lartësisë së dënimit gjykata pati parasysh të gjitha rrethanat të cilat në kuptim të neni 73 të KPRK-së ndikojnë në përcaktimin e llojit dhe lartësisë së dënimit.

Gjykata të akuzuarit si rrethana lehtësuese i mori parasysh pranimin e fajësisë, faktin se nuk ka të dhëna se më parë ka qenë i dënuar për ndonjë vepër penale, e njëjstu i akuzuari e ka kompensuar dëmin, pasi që telefoni i është kthyer pronarit-të dëmtuarit, ndërsa rrethana veçanërisht rënduese gjykata nuk gjeti. Gjykata të pandehurit i shqiptoj një dënim me gjobë duke marrë parasysh shkallën e përgjegjësisë penale, rrethanave të kryerjes së veprës nga neni 46 par.3 të KPRK-së, duke aplikuar nenin 74 par.1 nënpar 6, 3.10 të KPRK-së, me të cilin dënim do të arrihet qëllimi ndëshkimor në kuptim të preventivës speciale dhe asaj gjenerale i paraparë me nenin 41 të KPRK-së.

Konform nenit 463 par.3 të KPPRK-së, gjykata të E dëmtuara [REDAKTUAR] nga Ferizaji, Rruga [REDAKTUAR] pa nr., për realizimin kërkesë pasuroro-juridike udhëzohet në kontest civil.

Në bazë të nenit 450 dhe 451 të KPPRK-së, gjykata të akuzuarin e obligoi që të paguaj paushallin gjyqësor në shumë prej 20 €, në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përbarimit me dhunë.

Konform nenit 39 par.3.1 të Ligjit për Kompensimin e Viktimave të Krimit –Ligji nr.05/L-036, Obligohet i akuzuari që në emër të Taksës për Kompensimin e Viktimave të Krimit të paguaj shumën prej 30 eurove, në afat prej 15 ditëve, nën kërcënimin e përbarimit të dhunshëm.


Në bazë të së theksuarës më lartë u vendos si në disozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ

P. nr.1530/17 dt.25.04.2018

Zyr.ligjor
Gazmend Bytyq

Gjyqtari,
Elmaz Zenuni



KËSHILLA JURIDIKE

Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa,
në afat prej 15 ditëve nga dita e pranimit të aktgjykimit,
Gjykatës së Apelit në Prishtinë. Ankesa dorëzohet nëpër mes të kësaj gjykate.